- 27.2. Për shfrytëzimin e palestrës së sporteve, jashtë organizimeve që bënë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Kuvendi i Komunës, nga subjekte tjerë të ndryshëm dhe qytetarët paguhen këto tarifa:

27.2.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1	Për stërvitje të klubeve private dhe stërvitje të lira sportive për një orë pa	0.00 €

	ndriçim	
2	Për stërvitje të njëjta për një orë me ndriçim	0.00€
3	Për zhvillimin e ndeshjeve mes klubeve për ndeshjen pa ndriçim	0.00 €
4	Për zhvillimin e ndeshjeve mes klubeve për ndeshjen me ndriçim	0.00 €
5	Për termine tjera nga qytetarët për një orë pa ndriçim	0.00 €
6	Për termine tjera nga qytetarët për një orë me ndriçim	0.00 €

27.3. Për shfrytëzimin e palestrës së sportit për manifestime dhe ngjarje të ndryshme si:

1. Për ngjarje komerciale: panaire, revy, ekspozita dhe fushata të grupeve politike për orë 50€
2. Për ngjarje humanitare: seminare edukative, akademi përkujtimore, fushata edukative popullore, evente humanitare të tjera shfrytëzimi i palestrës është gratis.

27.4 Te klubet që nuk janë të Komunës së Malishevës, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara t'a shfrytëzojnë palestrën e sporteve në Malishevë për zhvillimin e takimeve (ndeshjeve) duhet të paguajnë për ndeshje tarifën 50 €

Shfryrëzimi i Shtëpisë së Kulturës „Tahir Sinani”

27.5. Për shfrytëzimin e shtëpisë së kulturës, jashtë organizimeve që bënë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Kuvendi i Komunës, nga subjekte tjerë të ndryshëm dhe qytetarët paguhen këto tarifa:

27.5	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Përrurime të Librave	0.00 €
2.	Ekspozita Artistike	0.00 €
3.	Koncerte dhe shfaqje të ndryshme	0.00 €
4.	Tubime Elektorale	50.00 €
5.	Akademi përkujtimore, aktivitete humanitare dhe organizime apo manifestime me karakter Kombëtar dhe të ngjashme janë të liruara nga pagesa	

Neni 28

Gjobat e shqiptuara për shkelje kundërvajtëse në trafik i takojnë komunës. Alokimi i mjeteve të inkasuara bëhet sipas dispozitave të rregullativës së thesarit.

Mjetet e inkasuara mund të jenë si rrjedhojë e dënimeve mandatore, përmes Policisë së Kosovës dhe vendimeve përfundimtare të gjykatës kompetente.

Neni 29

Ndryshimi dhe Plotësimi

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, me propozimet e arsyetuara nga propozuesi.

Neni 30

Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregullore kujdeset, Kryetari i Komunës përmes Drejtorive Komunale.

Neni 31
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja nr.02/570 datë: 29.12.2020 për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2021 e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevs me datë: 24.12.2020.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.


KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Nr. 02/154
Dt. 02-04-2021

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

v.v





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevë Rrahim Morina, Kryesues i mbledhjes së Kuvendit të Komunës së Malishevë	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:		
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL	Datë: 18.01.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	43-1016
1. Zyrtari-konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Edmond Kuka, Zyrtar për monitorim të komunave	
Lëndë:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Malishevës nga Komisioni ndërministrorë.	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar "Rregullore për taksë, ngarkesa dhe gjëra Komunale" për vitin 2021, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Komisionin ndërministrorë.

Bashkangjitur gjeni raportet e vlerësimit të Komisionin ndërministrorë.

Edmond Kuka

From: Krenare Sfishta
Sent: Tuesday, January 12, 2021 9:13 AM
To: Edmond Kuka
Cc: Naim Shala; Alush Beqiri; Erdon Arifaj; Sebahate Bardhi; Ahmet Durmishi; Liridon Neziri; Gjejrane Gashi; Safete n. Makolli
Subject: FW: MPB-Përgjigje-- Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

I nderuar,

Referuar kërkesës tuaj, lidhur me aktin e komunës së Malishevës, strukturat përkatëse të MPB-së kanë bërë vlerësimin e ligjshmërisë dhe ju njoftojmë si në vijim:

ARC/DGJC-ja

E nderuar,

Sa i përket Rregullores së Komunës Malishevë, tek neni 18, propozojmë që:

Tabela 18.2

Pika 4. "Deklaratë për bashkësinë familjare"

Pika 5. "Certifikatë e Gjendjes Martesore"

Pika 22. "Vërtetim nga arkivi"

Në vend të shprehjeve LAL, LAM dhe LAV të përdoren: "Regjistri i Lindjes"; "Regjistri i Martesës"; "Regjistri i Vdekjes"

Te tabela 18.2

Pika 6 "Regjistrimi me vonesë në Regjistrin e Lindjes"

Pika 10 "Anulimi, korrigjimi i gabimeve në Regjistrin e Lindjes"

Pika 20 "Regjistrimi me vonesë në Regjistrin e Vdekjes"

Po ashtu, propozojmë që në kuadër të rregullores, të vendosen masat ndëshkuese siç parashihen në Ligji Nr. 04/L -003 për Gjendjes Civile, Neni 63 Gjobat:

1. Me gjobë dënohet personi për këto shkelje:

1.1. prej njëzet (20) deri pesëdhjetë (50) Euro kur nuk paraqet lindjen e fëmijës në afatin e paraparë me këtë ligj;

1.2. prej pesëdhjetë (50) deri njëqind (100) Euro kur nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas këtij ligji;

1.3. prej njëzet (20) deri pesëdhjetë (50) Euro kush kryen varrimin pa leje.

Zbatimi i nenit paragrafit 1.1 dhe 1.2 është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 24/2015 për regjistrimin e mëvonshme, ku për secilin regjistrim të mëvonshëm kërkohet fletëpagesa që dëshmon pagesën e gjobës ashtu siç përcaktohet në nenin 63 të këtij ligji.

Përcaktimi i tarifave për lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile është kompetencë Komonale dhe kjo nuk interferon në kompetencat e ARC.

P.S. Propozojmë që Komunat të krijojnë një format të rregulloreve dhe të unifikohen taksat për lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile, për aq sa është e mundur.

AME-ja

Referuar kërkesës nga ju dhe bazuar në Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, AME ka shqyrtuar aktin e Komunës së Malishevës, pra, Rregulloren për taksa komunale për vitin 2021, pas analizimit dhe vlerësimit Agjencia e Menaxhimit Emergjent, konstaton se rregullorja e aprovuar është në harmoni me legjislacionin në fuqi, sa i përket fushëveprimit të Institucionit ton.

Përgjigjja nga DSHAM-ja

Nuk kemi vërejtje

Me respekt,

KRENARE ALLAQI - SFISHTA

Udhëheqëse e Divizionit për

Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Departamenti Ligjor-- Ministria e Punëve të Brendshme

E-mail:krenare.sfishta@rks-gov.net

tel: 038-200-19-664--- mob: 044-413-237

From: Krenare Sfishta

Sent: 05 January 2021 08:14

To: Alush Beqiri <Alush.Beqiri@rks-gov.net>; Erdon Arifaj <Erdon.Arifaj@rks-gov.net>; Sebahate Bardhi <Sebahate.Bardhi@rks-gov.net>; Liridon Neziri <Liridon.Neziri@rks-gov.net>

Cc: Naim Shala <Naim.Shala@rks-gov.net>; Blerim Camaj <Blerim.Camaj@rks-gov.net>; Fadil Kodra <Fadil.Kodra@rks-gov.net>; Ahmet Durmishi <ahmet.durmishi@rks-gov.net>; Valon Krasniqi <Valon.Krasniqi@rks-gov.net>; Gjejrane Gashi <Gjejrane.Gashi@rks-gov.net>; Safete n. Makolli <safete.n.makolli@rks-gov.net>

Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komonale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

Të nderuar/a,

Referuar kërkesës nga MPL-Ja (shih si më poshtë) kërkojë nga ana juaj që secili në fushën e vetë të shqyrtoni aktin e Komunës së Malishevës, pra, Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2021 dhe të ktheni përgjigje lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë me qëllim që të njëjtën në emër të MPB-së ta përcjellim në MPL-a.

Tash më jeni në dijeni, ashtu siç keni vepruar me aktet tjera, duhet të vazhdoni njëjtë edhe me këtë akt, sepse kemi të bëjnë me çështje të njëjtë.

Me qëllim që ti përmbahemi afatit të përcaktuar nga MPL-ja përgjigjet tuaj i dërgoni më së largu deri me dt. 10.01.2021

Për çdo paqartësi më kontaktoni!

Me respekt,

KRENARE ALLAQI - SFISHTA

Edmond Kuka

From: Isah Rudaku
Sent: Tuesday, January 5, 2021 9:16 AM
To: Edmond Kuka
Cc: Hasan Sejfiqaj; Xhevat Tafa; Venera Çerkini
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës
Attachments: 43-1016-2020.pdf

I nderuari z. Kuka,

Në mbështetje të kërkesës tuaj për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktëve të komunave, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Vendimit Nr.02/1097 të Sekretares së Përgjithshme të MAPL lidhur me shqyrtimin e "Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2021" të Komunës së Malishevës, informojmë me sa vijon:

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MA-NR.12/2005 për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore – drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale-teknike, të datës 16.05.2005 e në mbështetje të Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba të Komunës së Malishevës që nuk janë të përfshira taksat komunale për shërbime profesionale për prerje të pyjeve private dhe kullotje të bagëtive propozojmë që të përfshihen në Rregulloren e lartpërmendur, si vijon:

Neni 23 pas paragrafit 23.24 shtohet dy paragraf i ri 23.25, dhe 23.26

23.25. Shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private:

- a) Dru Zjarri për m³ ----- 1.50€
- b) Dru Zjarri mbi 7 m³ -----2.00€
- c) Dru Teknik m³ ----- 2.50€

23.26. Taksa për kullotjen e bagëtisë (për një (1) vit:

- a) Gjedhe mbi një vjetcopë.....1.20€
- b) Viçat.....copë.....0.80€
- c) Delet.....copë.....1.20€
- d) Qengjat.....copë.....0.80€
- e) Kuajt dhe gomarët.....copë.....1.90€
- f) Derrat.....copë.....1.60€
- g) Derrkuca.....copë.....0.90€.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2021" të Komunës së Malishevës, është në pajtim me nënin 12 paragrafi 12.1, 12.2 pika (c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28/04 Qershor 2008).

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të MPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,

From: Edmond Kuka

Sent: 2020-12-30 1:49:MD

To: Isah Rudaku <Isah.Rudaku@rks-gov.net>; Krenare Sfishta <Krenare.Sfishta@rks-gov.net>; Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>; Safete n. Makolli <safete.n.makolli@rks-gov.net>; Ardian Mehmeti <Ardian.Mehmeti@rks-gov.net>; Mirvete Kelmendi <Mirvete.Kelmendi@rks-gov.net>; Razije Murtezaj <Razije.Murtezaj@rks-gov.net>; Avni Rexha <Avni.Rexha@rks-gov.net>; Feim Hoxha <Feim.Hoxha@rks-gov.net>; Rexhep Bllaca <Rexhep.Bllaca@rks-gov.net>; Naim R. Zeqiri <Naim.R.Zeqiri@rks-gov.net>; Bislim Bislimi <bislim.bislimi@rks-gov.net>; Nafije Osmani <Nafije.Osmani@rks-gov.net>

Cc: Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Venera Çerkini <Venera.Cerkini@rks-gov.net>

Subject: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

Të nderuar/a,

Bazuar në Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave si dhe Vendimit Nr. 02.1097, të Sekretares së Përgjithshme të MPL-së është bërë themelimi i komisionit të përbashkët ndërministror për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave që prekin fushat e dy a më shumë ministrive. Koleg/e të nderuar ju ftojë për shqyrtimin e ligjshmërisë së "Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021", të komunës së Malishevës.

Bashkangjitur gjeni "Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021" të komunës së Malishevës.

Për shkak të pandemisë nga virusi Covid-19, dhe rekomandimet e dala nga Ministria e Shëndetësisë ju lutem që secili të dërgojë vlerësimin e tyre në formë elektronike, në këtë email : edmond.kuka@rks-gov.net

Lutem që vlerësimin të ma dërgoni më së largu deri me datën 13.01.2020(e mërkurë).



Republika e
Kosovës

Me respekt,

Edmond Kuka

Zyrtar për Monitorim të Komunave

Qervertaria e Republikës së Kosovës

Ministria e Pushteti Lokal

Departamenti Ligjor dhe Monitorim i Komunave

Edmond Kuka

From: Ardian Mehmeti
Sent: Tuesday, January 5, 2021 11:10 AM
To: Edmond Kuka
Cc: Ardian Bajraktari; Floriana Rugova; Xhevat Tafa
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës
Attachments: 43-1016-2020.pdf

I nderuar z. Kuka,

Lidhur me Projekt Rregulloren e bashkëngjitur të Komunës së Malishevës, dispozitat ndëshkimore të përcaktuara nga neni 8 deri në nenin 12 të Projekt Rregullores, konkretisht gjobat mandatore, janë brenda limiteve të përcaktuara në Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtjet.

Por, me rastin e përcaktimit dhe shqiptimit të këtyre gjobave, Komuna e Malishevës duhet ta ketë parasysh faktin për sanksionin kundërvajtës me gjobë ndaj personit fizik apo personit juridik, kur bëhet fjalë për kundërvajtje sipas nenit 29 (paragrafi 4) apo për kundërvajtje të lehta sipas nenin 29 (paragrafi 5) të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

Pra, duhet të specifikohet se për çfarë lloj kundërvajtjesh bëhet fjalë dhe të shqiptohen gjobat mandatore, konform nenit 29 (paragrafi 4) apo konform nenit 29 (paragrafi 5) të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, kur bëhet fjalë për personin fizik, personin fizik që ushtron biznes individual, personin juridik dhe personin përgjegjës të personit juridik.

Në të gjitha mënyrat, sanksioni kundërvajtës me gjobë duhet të jetë në përputhje dhe brenda limiteve të këtyre dispozitave.

Mbetemi në dispozicion për sqarime të tjera shtesë nëse konsiderohet e nevojshme.

Faleminderit,

ARDIAN MEHMETI
Zyrtar Ligjor
Departamenti Ligjor/Ministria e Drejtësisë
Adresa: Ndërtesa e ish pallatit të shtypit "Rilindja",
Kati VII, zyra nr. 703, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 200 18 131
Mob: +383 (0) 49 55 77 52
Email: ardian.mehmeti@rks-gov.net
Web: www.md.rks-gov.net

From: Edmond Kuka
Sent: Wednesday, December 30, 2020 1:49 PM
To: Isah Rudaku; Krenare Sfishta; Sabrie Rama; Safete n. Makolli; Ardian Mehmeti; Mirvete Kelmendi; Razije Murtezaj; Avni Rexha; Feim Hoxha; Rexhep Bllaca; Naim R. Zeqiri; Bislim Bislimi; Nafije Osmani
Cc: Xhevat Tafa; Venera Çerkini
Subject: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

Edmond Kuka

From: Mirvete Kelmendi
Sent: Wednesday, January 6, 2021 10:19 AM
To: Edmond Kuka
Cc: Ardian Mehmetaj; Aferdita Syle Hoxha; Xhevat Tafa
Subject: RE: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

I nderuar,

Ministria e Shëndetësisë institucion përgjegjës në fushën e shëndetësisë ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, Rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr.02/570 të dt.29.12.2020 të miratuar nga KK.Malishevë dhe ka vlerësuar se Rregullorja nuk është në pajtueshmëri të plotë me Udhëzimin Administrativ për Certifikatat Shëndetësore Nr.04/2013, te neni 25 (Tabela e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore në nivel parësor), pika 18 e Rregullores.

Udhëzim administrativ Nr.04/2013 zbatohet nga Institucionet Shëndetësore të cilat lëshojnë certifikata shëndetësore dhe përcakton llojet e certifikatave shëndetësore, institucionet shëndetësore, komisionet mjekësore, punëtorët shëndetësor, kushtet për lëshimin e certifikatave shëndetësore si dhe çmimoren për shërbime.

Ligji për Shëndetësi nr. 04/L 125, neni 8 dhe 18 përcakton se politikat shëndetësore hartohen nga Ministria e Shëndetësisë përfshirë edhe kujdesin parësor shëndetësor andaj të gjitha aktet e Komunave në fushën e shëndetësisë. duhet të jenë në përputhje me politikat nacionale për KPSH.

Me Respekt,
Mirvete Kelmendi

Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit.

Departamenti Ligjor, MSh
Te. Zyre:+381(0)38 200 24 101

From: Edmond Kuka
Sent: 2020-12-30 1:49.MD
To: Isah Rudaku <Isah.Rudaku@rks-gov.net>; Krenare Sfishta <Krenare.Sfishta@rks-gov.net>; Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>; Safete n. Makolli <safete.n.makolli@rks-gov.net>; Ardian Mehmeti <Ardian.Mehmeti@rks-gov.net>; Mirvete Kelmendi <Mirvete.Kelmendi@rks-gov.net>; Razije Murtezaj <Razije.Murtezaj@rks-gov.net>; Avni Rexha <Avni.Rexha@rks-gov.net>; Feim Hoxha <Feim.Hoxha@rks-gov.net>; Rexhep Bllaca <Rexhep.Bllaca@rks-gov.net>; Naim R. Zeqiri <Naim.R.Zeqiri@rks-gov.net>; Bislim Bislimi <bislim.bislimi@rks-gov.net>; Nafije Osmani <Nafije.Osmani@rks-gov.net>
Cc: Xhevat.Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Venera Çerkini <Venera.Cerkini@rks-gov.net>
Subject: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

Të nderuar/a,

Edmond Kuka

From: Sabrie Rama
Sent: Tuesday, January 5, 2021 11:13 AM
To: Edmond Kuka
Cc: Florije Kika; Xhevat Tafa
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës
Attachments: 43-1016-2020.pdf

I nderuar,

Më poshtë gjeni përgjigjen e Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave -Divizionit për Menaxhimin e Ndotjes Industriale-, lidhur me Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021” të komunës së Malishevës

Përgjigjet nga Departamentete-Agjencitë tjera, posa të arrijn do ti procedojm.

Me respekt!

From: Naim Alidema
Sent: Tuesday, January 05, 2021 10:59 AM
To: Sabrie Rama
Cc: Fatos Qerimi; Muhamet Malsiu; Visare Hoxha; Malsore Jonuzi
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

E nderuar,

Referuar shkresës tuaj lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021” të komunës së Malishevës; ju njoftojmë me sa vijon:

Pas shqyrtimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021” të Komunës së Malishevës., Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, nuk ka gjetur ndonjë kriter për llogaritjen e vlerës së tarifës që ndërliidhet me Udhëzimin Administrativ për Lejen Mjedisore Komunale Nr.01/2017, andaj për kriter e llogaritjes së vlerës së tarifave qe nuk nderlidhen me Lejen Mjedisore Komunale nuk kemi komente.

Duke u mbështetur në përgjegjësitë ligjore, mbetemi të përkushtuar në bashkëpunimin e ngushtë me Zyren Ligjore.

Me respekt,

NaimAlidema

From: Sabrie Rama
Sent: Thursday, December 31, 2020 11:55 AM

Edmond Kuka

From: Sabrie Rama
Sent: Tuesday, January 5, 2021 2:01 PM
To: Edmond Kuka
Cc: Florije Kika; Xhevat Tafa
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës
Attachments: 43-1016-2020.pdf

I nderuar,

Më poshtë gjeni përgjigjen e Divizionit të Planifikimit Hapësinor, përkitazi me me Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021" të komunës së Malishevës.

Me respekt!

From: Suzana.Goranci
Sent: Tuesday, January 05, 2021 1:57 PM
To: Sabrie Rama
Cc: Servet Spahiu; Florije Kika; Adelina Vatovci
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

E nderuar,

Te poshtëshënuar gjeni përgjigjen e shqyrtimit të ligjshmërisë në aspektin profesional për procedim të mëtuftjeshëm

Gjitha të mirat,
Suzana

From: Lindita Radoniqi
Sent: Tuesday, January 5, 2021 11:47 AM
To: Suzana.Goranci <Suzana.Goranci@rks-gov.net>
Cc: Servet Spahiu <Servet.Spahiu@rks-gov.net>; Adelina Vatovci <Adelina.Vatovci@rks-gov.net>
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

Të nderuar,

Divizioni i Planifikimit Hapësinor pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021" të komunës së Malishevës, njofton me sa vijon:

Sa i përket Planifikimit hapësinor neni 22. Mund të kërkohet taksa nga autoritetet komunale!

LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

Neni 22

Kopjet e Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor Autoritetet kompetente komunale ofrojnë kopje të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor për secilin që i kërkon ato. Autoriteti komunal mund të ngarkojë një taksë të kostos reflektuese për çdo kopje.

Me respekt

Edmond Kuka

From: Sabrie Rama
Sent: Tuesday, January 5, 2021 2:06 PM
To: Edmond Kuka
Cc: Florije Kika; Xhemail Metolli
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

I nderuar,

Të poshtëshenuar gjeni përgjigjen e Divizionit për Mbeturina dhe Kimikate, lidhur me Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2021, të Komunës së Malishevës.

Me respekt!

From: Ibrahim Balaj
Sent: Tuesday, January 05, 2021 9:44 AM
To: Sabrie Rama
Cc: Muhamet Malsiu; Enver Tahiri; Ismail Hetemaj; Visare Hoxha; Florije Kika; Shiqerl Dermaku; Lendita Sopa
Subject: RE: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

E nderuar,

Pas shqyrtimit të kërkesës të MPL me numer protokoli – VI- 43-1016, të datës: 30.12.2020, pranuar në formë elektronike përmes emailit, për vlerësim të ligjshmërisë të Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2021, të komunës së Malishevës, Divizioni për mbeturina dhe kimikate vlerëson se Rregullorja në fjalë nuk është e thirrur në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina.

Meqenëse, Rregullorja për Taksa/tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2021, përshkruan edhe gjodat mandatore për mbeturina nën 12, pika 13 e kësaj Rregullore dhe se përcaktimi i taksës/tarifës për shërbimin publik për mbledhje dhe bartje të mbeturinave komunale është në kompetencë dhe përgjegjësi të komunës, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina, duhet që në preambul të Rregullores të shënohen dispozitat e Ligjit për mbeturina apo të rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave nëse ka nxjerr komuna.

Vërejtje

Në kauder të kësaj Rregullore duhet të përcaktohet edhe tarifa/taksa për shërbimin publik për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave komunale.

Me respekt,
Ibrahim Balaj

From: Enver Tahiri
Sent: Sunday, January 3, 2021 3:30 PM
To: Ibrahim Balaj <Ibrahim.Balaj@rks-gov.net>
Subject: Fw: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

Pershendetje Ibro ,

Edmond Kuka

From: Sabrie Rama
Sent: Wednesday, January 6, 2021 10:47 AM
To: Edmond Kuka
Cc: Xhevat Tafa; Florije Kika
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

I nderuar,

Të poshtëshenuar gjeni përgjigjen e Divizionit për Ujëra, lidhur me Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2021, të Komunës së Malishevës.

From: Fatmire Mani
Sent: Wednesday, January 06, 2021 10:16 AM
To: Sabrie Rama
Cc: Muhamet Malsiu; Shiqeri Dermaku; Florije Kika
Subject: RE: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

E nderuara Sabrie,

lidhur me kërkesën tuaj për "Shqyrtimin e ligjshmërisë së Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021" të komunës së Malishevës", opinionin vijues:

Problematika: "Shqyrtimi i ligjshmërisë së "Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021" të komunës së Malishevës në kontekst të Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës

Ligji/Kriteret: Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës

Analiza: 1. Fusheveprimi i Rregullores në fjale, respektivisht dispozitat rregullore, ndërlidhen vetëm me çështjet rregullore të shërbimeve për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale;

2. Ligji Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës, ka fusheveprimtari rregulluese "çështjet që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësorë, liqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë, tokat e lagëta, truallin buzë brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre; përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë përmbytjet, vërshimet, thatësitë, erozionin, objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohet ose shkarkohen ujërat"

Konkluzioni: Draft Rregullorja në fjale nuk interferon dispozitat rregullore të Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës.

Edmond Kuka

From: Sabrie Rama
Sent: Friday, January 8, 2021 8:39 AM
To: Edmond Kuka
Cc: Xhevat Tafa; Florije Kika
Subject: FW: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

I nderuar,

Të poshtëshenuar gjeni përgjigjen e Agjencionit Kadastral të Kosovës, përkitazi me Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 të Komunës së Malishevës nr. 43-1016.

Punë të mbarë!

From: Bashkim Shaqiri
Sent: Wednesday, January 06, 2021 3:14 PM
To: Sabrie Rama
Cc: Avni Ahmeti; Florije Kika; Nadir Shyqeriu
Subject: RE: Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 - Komuna e Malishevës

E nderuar,

Agjencia Kadastrale e Kosovës shqyrtoi kërkesën tuaj për vlerësim të ligjshmërisë së Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 të Komunës së Malishevës nr. 43-1016, të datës 30.12.2020.

Neni 23 i kësaj rregullore ka të bëjë me taksat e përcaktuara për Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër. Taksat e nerit 23 janë të përcaktuara me anë të Udhëzimit Administrativ 05/2012 për tarifën e shërbimeve dhe të produkteve kadastrale të ofruara nga ZKK (zyrat komunale kadastrale) dhe kompanitë gjeodete të licencuara, dhe Udhëzimit Administrativ 08/2014 për tarifën e regjistrimit të drejtave të pronës së paluajtshme nga ZKK.

AKK Propozon që në Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2021 të Komunës së Malishevës nr. 43-1016, të datës 30.12.2020, të ndryshohet ose fshihet neni 23 që ka të bëjë me taksat për Drejtorinë e Kadastrit.

Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2014, është i shfuqizuar me Udhëzimin Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për tarifën e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme, ndërsa Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2012, është i shfuqizuar me Udhëzim Administrativ MMPH – Nr. 12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës.

Tarifat e përcaktuara në nenin 23 që kanë të bëjnë me kadastrin janë të përcaktuara sipas UA të shfuqizuara.

AKK rekomandon që Tarifat për shërbimet kadastrale të mos jenë të përfshira fare në Rregulloret e Komunave, pasi që Agjencia Kadastrale e Kosovës është kompetente për propozimin e tarifave për ofrimin e shërbimeve kadastrale.

Me respekt!